



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 568/3 Prot.

Tiranë, më 22/5 2017

REKOMANDIM

Nr. 12 datë 22/5 2017

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, neneve 77-112 të Ligjit nr.44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit Universiteti i Tiranës,

VËREJ SE:

Në zbatim të Urdhrit Nr.84 datë 27.03.2017 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit Universiteti i Tiranës me objekt kontrolli:

- Zbatimi i Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit Universiteti i Tiranës.

Grupi i kontrollit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale, u asistua nga përfaqësuesit e kontrolluesit, të cilët ishin njohur me Urdhrin Nr. 84 datë 27.03.2017 të Komisionerit.

Kontrolluesi, Universiteti i Tiranës ushtron aktivitetin e tij në arsimin universitar nëpërmjet fakulteteve të ndryshme si: Fakulteti Ekonomik, Juridik, Shkenca Sociale, Histori – Filologji, Shkencat e Natyrës dhe Gjuhët e Huaja. Grupi i hetimit administrativ ushtroi kontroll jo vetëm në rektorat por dhe pranë disa fakulteteve të mësipërme, dhe konkretisht në: Fakultetin Ekonomik, Histori – Filologji dhe Shkencat e Natyrës.

Kontrolluesi, Universiteti i Tiranës, përpunon të dhëna personale kryesisht për subjektet e dhënave të 2.000 "*punëmarrësve*" dhe të 35 000 "*studentëve*". Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale (nëpërmjet dokumentacionit në formatin letër) si dhe në mënyrë elektronike nëpërmjet sistemeve të teknologjisë së informacionit të tilla si sistemi i video-vëzhgimit (CCTV), portali i studentit, portali zyrtar i institucionit, pajisje kompjuterike etj.

Gjatë hetimit administrativ të ushtuar në vend, është konstatuar se:

1. Kontrolluesi ka "*Njoftuar*" Zyrën e Komisionerit në lidhje me përpunimin e të dhënave personale. Konstatohet se për shkak të ndryshimeve në kohë në lidhje me mbledhjen.

përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale gjatë ushtrimit të aktivitetit, është i nevojshëm përditësimi dhe rivlerësimi i këtij "Njoftimi".

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 21 dhe 22 të ligjit - "1. Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë."

2. Kontrolluesi nuk ka nënshkruar "Deklaratë Konfidencialiteti" me punëmarrësit të cilët kanë akses në mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale.

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 28 të ligjit - "Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj.

Çdo person që vepron nën autoritetin e kontrolluesit, nuk duhet t'i përpunojë të dhënat personale, tek të cilat ka akses, pa autorizimin e kontrolluesit, përveçse kur detyrohet me ligj."

3. Kontrolluesi mbikëqyr ambientet e brendshme dhe të jashtme nëpërmjet sistemit të video-vëzhgimit (CCTV). Kamerat janë vendosur në hyrje të ambienteve ku ushtron aktivitet si dhe në korridore. Kontrolluesi nuk disponon rregullorë për funksionimin e këtij sistemi. Koha e ruajtjes së të dhënave imazhe-video është 12 ditë. Konstatohet se në disa nga ambientet e kontrolluesit (si Rektorati dhe Fakulteti i Shkencave të Natyrës) janë vendosur tabela informuese mbi prezencën e sistemit të video-vëzhgimit (CCTV) por në ambientet e Fakultetit të Ekonomisë ato nuk janë vendosur në përputhje me formatin standard të miratuar në Udhëzimin Nr.3 të Komisionerit.

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 18 të ligjit - "1. Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do t'i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit...".

4. Kontrolluesi ka publikuar në portalin zyrtar <http://www.unittir.edu.al> "Politikat e Privatësisë", por konstatohet se në institucionet e varësisë si Fakulteti i Gjuhëve të Huaja (<http://fgjh.edu.al>), Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë (<http://www.fhf.edu.al>), Fakulteti i Drejtësisë (<http://fdut.edu.al>) dhe Fakulteti i Ekonomisë (<http://www.feut.edu.al>), "Politikat e Privatësisë" nuk janë publikuar. Informacioni i publikuar në "Politikat e Privatësisë", ka për qëllim informimin e subjekteve të të dhënave që vizitojnë këtë portal, mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave, masat e sigurisë, ruajtjes së konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 18 të ligjit - "1. Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do t'i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit...".

5. Kontrolluesi nuk ka parashikuar masa dhe veprime të përshtatshme tekniko organizative në lidhje me ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave si dhe vazhdimësinë e punës (backup/restore), në rast dëmsh apo katastrofash, në lidhje me sistemin e informatizimit të Universitetit të Tiranës. Gjithashtu, masat nuk janë parashikuar as në kontratën me mirëmbajtjes (shërbimit) lidhur më datë 14.07.2015. Konstatimet i referohen kontratës së furnizimit me objekt "Informatizimi i Universitetit të Tiranës" dhe kontratës së shërbimit "Mirëmbajtja e sistemit të informatizimit të UT-së". Kontrolluesi nuk disponon kredencialet e Administratorit të sistemit të informatizimit, të cilat nuk janë vënë në dispozicion nga ana e përpunuesit (palës së kontraktuar).

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 20 të ligjit -"1. Kontrolluesit, për përpunimin e të dhënave personale, mund të punësojnë përpunues, të cilët garantojnë përdorimin e ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave. Çdo përpunues i të dhënave personale ka këto detyrime:

- a) të përpunojë të dhënat vetëm në përputhje me udhëzimet e kontrolluesit; të mos i transmetojë ato, përveç kur ka marrë udhëzim nga kontrolluesi;
- b) të marrë të gjitha masat e sigurisë, sipas këtij ligji dhe të punësojë operatorë, të cilët kanë detyrimin për ruajtjen e fshehtësisë;
- c) të krijojë, në marrëveshje me kontrolluesin, kushtet e nevojshme teknike dhe organizative për përmbushjen e detyrimeve të kontrolluesit, për të siguruar të drejtat e subjekteve të të dhënave personale;
- d) t'i dorëzojë kontrolluesit, pas përfundimit të shërbimit të përpunimit, të gjitha rezultatet e përpunimit dhe dokumentacionit, që përmban të dhëna ose t'i mbajë apo t'i shkatërrojë ato me kërkesë të kontrolluesit.
- e) të vërë në dispozicion të kontrolluesit të gjithë informacionin e nevojshëm, për të kontrolluar përputhshmërinë me detyrimet, që rrjedhin sipas shkronjave të mësipërme.

2. Detyrimet e pikës 1 përcaktohen në kontratën e shkruar e kontrolluesit me përpunuesin. "

Kontrolluesi Universiteti i Tiranës ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit shkresën Nr.1333/6 Prot., datë 03.05.2017, sipas të cilës vihej në dijeni Komisioneri mbi rikuperimet e konstatimeve të grupit të kontrollit, si më poshtë vijon:

1. Për konstatimin e parë, brenda ditës përditësua formularin e njoftimit, të cilin ja bashkëlidhim këtij akti.
2. Për konstatimin e pikës së dytë, të gjithë punëmarrësit që aksesojnë të dhëna personale pranë rektoratit të UT duke përfshirë gjithashtu dhe fakultetet, kanë nënshkruar deklaratat e konfidencialitetit.
3. Për konstatimin e pikës së tretë, me tabelat informuese janë pajisur të gjitha zonat e rektoratit të UT duke përfshirë gjithashtu dhe fakultetet, sipas standardit të miratuar nga Komisioneri.
4. Për sa i përket konstatimit të katërt, është realizuar publikimi i rubrikës "Politikat e Privatësisë" në portalin zyrtar www.unitir.edu.al në lidhje me të dhënat të cilat mblidhen nëpërmjet këtij portali nga fakultetet e UT.

Në zbatim të neneve 87-89 të Ligjit Nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", përpara marrjes së vendimit përfundimtar, kontrolluesi Universiteti i Tiranës, është njoftuar zyrtarisht për pjesëmarrje në seancën dëgjimore që do të zhvillohej në datën 11.05.2017, për të ushtruar të drejtën e tij për tu dëgjuar.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesi i kontrolluesit Universiteti i Tiranës u shpreh se janë në proces hartimi të rregullores për sistemin e vëzhgimit (CCTV), si dhe në rishqyrtim të kushteve të kontratës me karakter outsourcing, ku një nga pikat kryesore mbetet, disponimi i kredencialeve të Administratorit të sistemit të informatizimit, të cilat më parë nuk ishin vënë në dispozicion nga ana të përpunuesit (palës kontraktuar).

Rezulton se kontrolluesi, Universiteti i Tiranës, përgjithësisht i ka përmbushur detyrimet ligjore me përjashtim të pikës 3 pjesërisht dhe pikës 5 të konstatimeve, pra ai ka qenë në bashkëpunim serioz me grupin e kontrollit gjatë ushtrimit të hetimit administrativ dhe ka reaguar në mënyrë të menjëhershme për rikuperimin e shkeljeve.

Sa më sipër:

Në zbatim të nenit 18 dhe 32/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

REKOMANDOJ:

1. Në zbatim të nenit 27 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, dhe Udhëzimit Nr.3 datë 05.03.2010 të Komisionerit, kontrolluesi Universiteti i Tiranës, të hartojë rregullore për funksionimin e sistemit të vëzhgimit (CCTV).
2. Në zbatim të nenit 20 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, dhe Udhëzimit Nr.19, datë 03.08.2012 të Komisionerit, kontrolluesi Universiteti i Tiranës, të hartojë aneks-kontratën për përpunimin e të dhënave personale nga një kompani e tretë.
3. Kontrolluesi Universiteti Tiranës të kryejë plotësimet e detyrimeve të parashikuara në këtë Rekomandim, brenda afatit 10 ditor nga momenti i marrjes dijeni.
4. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 22/5/2017

